



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
REKTORATI

Nr. 892 prot

Durrës, më 30.6.2021

V E N D I M

Nr. 9, datë 30.06.2021.

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit të Universitetit, të Rregullores së Universitetit, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 30.06.2021,

V E N D O S I:

1. Ngarkimin e Dekanëve të fakulteteve, Drejtorisë Administrimit Financiar, në marrjen e masave për hartimin e projekt buxhetit brenda datës 28.07.2021.
2. Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve, për njohje me urdhërin nr.110, datë 25.05.2021 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë "Për riorganizimin e njësive kryesore të UAMD-së.
3. Marrjen e masave nga Administratori për pagesën e faturës për akreditimin institucional të UAMD-së.
4. Ngarkimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike për planifikimin e lejeve vjetore të lektorëve për vitin akademik 2020-2021e cila fillon nga data 31.07.2021 deri më 07.09.2021, pjesa e mbetur do të planifikohet sipas urdhërit që do të dalë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Juridike.
5. Nisur nga objektivi nr.1 i strategjisë së ndërkombëtarizimit për të shtyrë përpara procesin e diplomave të dyfishta/përbashkëta me institucione të arsimit të lartë në vendet e BE-së, nevojitet të ngrihet nga një grup pune në çdo fakultet i cili do të udhëheqë të gjithë procesin e diplomave të përbashkëta/të dyfishta. Në javën në vazhdim në Fakultete do të realizohen takimet me grupin e punës për vijueshmërinë e procesit. Ngarkohen Dekanët e fakulteteve të përcjellin emrat e antarëve që do të përbëjnë grupin e punës, brenda datës 01.07.2021.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Zv.Rektorët
 - Administratori
 - Dekanët e Fakulteteve
 - Drejtoria Burimeve Njerëzore dhe Juridike
 - Drejtoria e Administrimit Financiar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


R E K T O R
Prof.Dr. Kseanela SOTIROFSKI